REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

KONFIRMOHET Nr. 710/8 Prot. 03.06.2016 PREFEKTI I QARKUT LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MIRDITË

# VENDIM

Nr. 71 datë 25 / 05 / 2016

## PER

## "NJË NDRYSHIM NË VENDIMET NR. 43.DATË 29.02.2016 DHE NR 49 DATË 30.03.2016 PËR CAKTIMIN E KUFIJEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË MIRDITË DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI"

Mbeshtetur në nenin 54 pika ç ligjit 139/2015" Për Vetëqeverisjen Vendore", ne ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikes e Shqiperise" ne ligjin Nr.-147/2015 . "Për Buxhetin e Vitit 2016", ne Udhezimin Nr.1 date 15.01.2016 te Ministrise se Financave " Per zbatimin e buxhetit te vitit 2016" ne VKM nr. 165 dt. 02.03.2016 Per grupimin e Njesive te Vetëqeverisjes Vendore ,per efekt page,dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të Njesive te Vetëqeverisjes Vendore . dhe ne VKM nr 717 dt 23.06.2009 i ndryshuar ,« Per pagat e punonjesve mbeshtetes te institucioneve buxhetore dhe te nepunesve te disa institucioneve buxhetore ». dhe 194 date 22.04.1999 i ndryshuar « Per Miratimin e Struktures se Pages se Punonjesve Mesimore ne Arsimin Parauniversitar ».
Keshilli i Bashkise pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Bashkia Mirdite ;

## VENDOSI:

**1.** Të miratojë nivelin e pagave të Nëpunësve Civil dhe të punonjësve të Bashkisë Mirditë dhe të njësive administrative si më poshtë ;

- Pergjegjës Sektori me ose pa Status Nëpunësi Civil, kur arsimi perputhet me fushen qe mbulon sektori qe drejton,grupi i diplomes 1 te trajtohet me kategorin III-a/1
- Pergjegjes Sektori me ose pa status Nenpunesi Civil, kur arsimi nuk perputhet me fushen qe mbulon Sektori qe drejton, grupi i diplomes 1 te trajtohet me kategorin III-b.

- Specialist të lartë, me diplomë të grupit 1 dhe 2, me ose pa Status Nëpunësi Civil ku vendi i punes eshte ne perputhje me arsimin (diplomimin ) , volumi dhe veshtiresia e vendit te punes qe mbulon eshte i nivelit te larte , per qendren e Bashkise , te trajtohet me kategorin III-b .

- Specialistet me arsim të lartë me ose pa Status Nëpunësi Civil ku vendi i punës është në përputhje me arsimimin e tij, grupi i diplomës 1,2,3 të trajtohen me kategorinë IV-a.

Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR II permes Qendres per Ceshtjet e Informimit Publik www.infocip.org www.vendime.al

- Specialistet me arsim të lartë me ose pa Status Nëpunësi Civil, ku vendi i punës nuk është në përputhje me arsimimin e tij grupi i diplomës 1,2,3 të trajtohen me kategorinë IV-b.

- Specialistet me arsim te lartë me ose pa Status Nëpunësi Civil, grupi 1,2,3 i diplomës në NJ.Q.V- të, të trajtohen me kategorine IV-b.

**2. Trajtohen sipas pikes 19 te VKM Nr.165. date 02.03.2016 keto kategori të punësauarve:**

- Specialiste te mesem ne qender 34 000 leke dhe 1% te pages minimale deri ne 25-vite
- Specialiste te mesem ne njesi, muzikant, piktor, teknik fonie, elektricist (Kultura) 28500 leke dhe 1% te pages minimale deri ne 25-vite

- Recepsion, Shofer,Pastruse Qender Bashkie 31000leke dhe 1% te pages minimale deri ne 25-vite

- Magazinier, Pastrues, punetor sherbimesh, (qender) 25 500 leke dhe 1% te pages minimale deri ne 25-vite

- Punetor sherbimesh dhe roje njesite e tjera 22 000leke dhe 1% te pages minimale deri ne 25-vite
- Caktimin e kufijeve te pagave te punonjesve institucioneve ne varesi (Agjensia e Puneve Publike dhe mirmbajtjes) sipas aneksit bashkelidhur.

**3.** Efektet financiare për pagën bazë, shtesat për pozicion dhe sipas klasave të fillojnë pas konfirmimit të Prefektit.

**4.** Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

| | |
|---|---|
| **S E K R E T A R I** | **K R Y E T A R I** |
| **Gasper TOPOLLAJ** | **Pjeter PJETRI** |

Dixhitalizuar në kuadër te projektit STAR II permes Qendrës per Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendime.al

Adresa. Sheshi " Abat DOÇI " RRESHEN tel dhe fax : (00355) (0) 21622233

Aneksi 1

CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË AGJENCISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **PAGA MUJORE (LEKË)** |
| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Paga individuale | | | Shtesa për pozicion |
| | 1. | | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion |
| II | II-b | Drejtor Drejtorie | 1 | 2 % | 0 | 57 000 |
| III | III-b | Përgjegjës sektori | 1 ose 2 | 2% | 0 | 40 000 |
| IV | IV-b | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | 27 500 |

Pagesa e punonjësve administrativ:

1. Shofer, fadromist, manovrator dhe mjeshtër të jetë 31 000 lekë dhe 1% të pagës minimale.

2. Punonjësit e tjerë administrativ të jetë 25 500 lekë dhe 1% të pagës minimale.

Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR II permes Qendrës për Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendime.al